



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 08-2008
Prishtinë, më 1 prill 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq, Melihate Tërmkolli, Selvije Halimi dhe Džezair Murati.

Të ftuarit: Ramadan Islami-OSBE, Petrit Hysaj-OSBE, Lumnije Murati-ZPK, Reshit Gashi-NDI, Robert Steere-NCSC.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Drita Çarkaxhiu dhe Behlul Zeka.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e 19 marsit 2008;
3. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik;
4. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;
5. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale;
6. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë;
7. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës dhe propozoi që pika katër e rendit të ditës të shtyhet për në fund.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin për pikën katër.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 19 marsit 2008

Kryetari-Pyeti anëtarët për vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik

Kryetari-Theksoi se janë pranuar edhe rekomandimet nga Këshilli i Evropës, përkatësisht eksperti i tyre.

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin dhe bëri amendamentet përfundimtare në të.

Pas shqyrtimit, Komisioni i miratoi amendamentet dhe kërkoi nga stafi mbështetës që ta dërgoj Projektligjin për lekturim.

4. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;

Adem Salihaj-i paraqiti amendamentet në këtë Projektligj dhe propozoi që në titull të hiqet fjala “i Përkohshëm”, pasi që pas 17 shkurtit nuk bën të vazhdojmë më të përkohshëm. Ai nënvizoi se Komisioni ka të drejtë ta ndryshojë.

Bajram Kosumi-U pajtua se fjala “i Përkohshëm” mund të hiqet, nëse më herët ka qenë e vendosur për arsye politike.

Kryetari-Vuri në pah se një ndryshim i tillë nuk ka mundësi të bëhet sepse duhet të pritet miratimi i Kushtetutës.

Kolë Berisha-Nuk u pajtua që të hiqet “i Përkohshëm”, sepse nëse hiqet do të shkaktojë probleme gjatë nënshkrimit të PSSP-ja.

Riza Smaka-Propozoi që “i Përkohshëm”, të futet në kllapa dhe t’i bëhet një fusnotë.

Adem Salihaj-Duke u ndërlidhur me parafolësit propozoi që të kërkohet mendim nga institucionet përkatëse ta definojnë pse është vendosur “i Përkohshëm”. Nëse është vendosur vetëm për shkak të statusit atëherë ta heqim, nëse është vendosur për shkaqe të tjera, atëherë të veprojmë ndryshe. Ai më tutje nënvizoi propozim-amendamentin 5, dhe

kërkoi që Ligji të hyn në fuqi 30 ditë pas nënshkrimit nga Kryetari i Kosovës, në mënyrë që t'u lejohet edhe Gjykatave kohë për ta shikuar.

Në diskutimin e anëtarëve të tjerë u sqarua se për këtë duhet të pritët për afatin të cilin e cakton Kushtetuta për hyrjen në fuqi të ligjeve.

Anëtarët e Komisionit konstatuan se nëse Kushtetuta miratohet deri me datën 14 prill, atëherë, Komisioni për Legjislacion dje Gjyqësi do të kërkojë që të gjitha ligjet të ndryshohen sipas afatit të caktuar në Kushtetutë. Referuesi për këtë projektligj, Adem Salihaj, e ngriti edhe çështjen e zbutjes së dënimit dhe theksoi se ka kundërthënie në lidhje me këtë, ngase diku thuhet 10 vjet ndërsa diku ndryshe. Ai propozoi që kjo të aplikohet edhe për dënimet afatgjate, për shembull nëse personi është dënuar 40 vjet, të shikohet mundësia e zbutjes.

Pas diskutimit për këtë pikë, Komisioni i miratoi amendamentet dhe vendosi që t'i drejtohet me një shkresë Departamentit Ligjor të Kuvendit për sqarime të mëtejshme në lidhje me fjalën “i Përkohshëm”.

5. Shqyrtimi i amendamenteve të Projektligjit për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë;

Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara një nga një.

Pas shqyrtimit të kësaj pikë, Komisioni njëzëri i miratoi në tërësi amendamentet dhe kërkoi nga stafi mbështetëses që t'i përgatit në formën e kërkuar.

Shqyrtimi i pikës 6 të Rendit të Ditës, vazhdoi me datën 2 prill 2008, pas Dëgjimit Publik të Projektligjit për Noterinë.

6. Shqyrtimi i propozim amendamenteve të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;

Kryetari-Lexoi amendamentet në këtë projektligj dhe filloi shqyrtimi i tyre nen për nen. Anëtarët pas shqyrtimit, kërkuan që të përmirësohen gabimet gjuhësore dhe unifikimi në të tre gjuhët.

Pas shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni i miratoi në tërësi amendamentet e Projektligjit për Ekzekutimin e sanksioneve Penale.

Kryetari i falënderoi edhe një herë të pranishmit dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Procesverbalin e hartoi:
Behlul Zeka, zyrtar ligjor

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni